canton de vaud
DEF Département de l'enseignement et de la formation professionnelle
DGEP Direction générale de l'enseignement postobligatoire

Office cantonal d'orientation scolaire et professionnelle
Direction
Rue de la Borde 3d
1014 Lausanne

Prindërve të nxënësve.seve të interesuar.a

Lozanë, shtator 2025

## Programme Info-Métiers

E dashur Zonjë, i dashur Zotëri, të dashur Prindër,

Shërbimi ynë i orientimit profesional i shoqëron nxënësit e shkollës së detyrueshme në zgjedhjen e formimit të tyre. Në këtë kuadër, ne kemi kënaqësinë t'ju paraqesim programin **Info-Métiers.**

Ky program propozon çdo vit, të mërkurat pasdite, një seri vizitash në ndërmarrje të cilat organizohen në bashkëpunim me ndërmarrje dhe shoqata profesionale të kantonit. Për këtë vit shkollor, këto vizita bëhen **nga tetori 2025 deri në prill 2026**.

**Një hyrje konkrete në botën profesionale**

Ky program u ofron të rinjve një rast unik :

- për të zbuluar nga brenda sektorët e ndryshëm të veprimtarisë ;
- për të shkëmbyer me profesioniste dhe profesionistë të pasionuar ;
- për tu informuar mbi formimet nistore dhe mundësitë e perfeksionimit;
- për të kuptuar kontekstin dhe pasuritë e botës së punës ;
- për ta përkryer mendimin për zgjedhjen e një formimi të përshtatshëm.

**Si të merret pjesë ?**

Regjistrimet janë hapur qysh tani. Për të parë vizitat e propozuara dhe për të regjistruar fëmijën tuaj, lutemi të shkoni në sitin :

→ **www.vd.ch/infométiers**

Ne ju falënderojmë për vëmendjen që do të tregoni ndaj këtij programi dhe ju drejtojmë, e dashur Zonjë, i dashur Zotëri, përshëndetjet tona të përzemërta.

Directrice

Emmanuelle Rossier